



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:203609
Datë: 26.12.2024
Numri i dokumentit: 06688861

C.nr.3027/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Greta Ibraj, në çështjen juridike – kontestimore të propozuesit Xh. I, nga Prishtina, rr. “I. J. K” nr...., ndaj kundërshtarëve të sigurimit: 1. T. S, me adresë banimi në P, rr. “H. T” nr. ...; dhe 2. A. K, nga P, rr. “A H” nr...., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson H. K, avokat në Prishtinë, duke vendosur sipas propozimit të propozuesit për caktimin e masës së sigurimit, pas mbajtjes së seancës dëgjimore, të datës 12.12.2024, më datë 26.12.2024 mori dhe përpiloi, këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi i pa bazuar propozimi i propozuesit Xh. I, nga P, me të cilin ka kërkuar që të caktohet masa e përkohshme e sigurisë ashtu që kundërshtarëve të sigurimit T. S, dhe A. K, u ndalohet që paluajtshmërinë nga Fleta Poseduese UL-xxxxxxxxx, Zona Kadastrale P, numri i njësisë P-xxxxxxxxxx0 me sipërfaqe 0.0075 ha (ose 75 m²) me kulturë shtëpi 26 m² dhe oborr 49 m², ZK P, te vendi i quajtur R. K, në P, ta tjetërsojnë, ta ngarkojnë me ndonjë detyrim hipotekar, apo ta ndryshojnë gjendjen ekzistuese të patundshmërisë, ose në ndonjë mënyrë tjetër të ndikojnë negativisht në të drejtat pronësore të propozuesit të sigurimit.

A r s y e t i m

Në këtë Gjykatë, më datë 12.09.2011 propozuesi i masës Xh. I nga P, ka paraqitur propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, ndaj kundërshtarëve të sigurimit T. S, dhe A. K. Të njëjtin propozim e ka precizuar sipas parashtrësës së datës 11.07.2024, duke rregulluar gabimin teknik përkitazi me numrin e njësisë kadastrale ndaj të cilës ka drejtuar propozimin për caktimin e masës së sigurimit.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin C.nr.1992/2011, të datës 23.05.2012 e ka refuzuar si të pa bazuar propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurimit. Ndaj këtij aktvendimi, propozuesi ka paraqitur ankesë, ndërsa Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit AC.nr.674/2024, të datës 22.02.2024, ankesën e propozuesit e ka aprovuar, e ka prishur Aktvendimi e ankimuar dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje. Në aktvendimin e saj, gjykata e shkallës së dytë, e ka sugjeruar gjykatën e shkallës së parë që të japë arsye të mjaftueshme në drejtim të plotësisimit ose jo të dy kushteve ligjore për caktimin e masës së sigurimit nga neni 297 par.1 pika a) dhe b) e LPK-së, pastaj, nëse e vlerëson të nevojshme të caktojë sërish

seancën për shqyrtimin e propozimit për masën e sigurimit, për të marrë nga palët informacionet e nevojshme lidhur me çështjet e cekura më lart, dhe në fund të vendosë në bazë të ligjit. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë është sugjeruar të kujdeset se propozuesi a ka paraqitur padi për vërtetimin e të drejtës së pronësisë për paluajtshmërinë për të cilën kërkohet vendosja e masës së sigurimit, e në rast se rezulton se propozuesi nuk ka paraqitur padi, gjykata duhet ta zbatojë këtë situatë dhe të zbatojë drejtë nenin 308 par.1 dhe 2 të LPK-së.

Propozuesi, në propozimin e dorëzuar me shkrim, ka deklaruar se kundërpropozuesi i parë, është pronar i paluajtshmërisë kontestuese. Ka theksuar se propozuesi dhe kundërpropozuesi i parë kanë kontaktuar shitjen e të njëjtës për çmimin prej 5,000.00 euro më datë 28.12.2007, me ç'rast blerësi i ka paguar shitësit shumën prej 500.00 euro në emër të kaparit, ndërsa më datë 19.07.2008 ka paguar edhe 950.00 euro, ashtu që shuma e kaparit ka arritur në 1,450.00 euro. Më tej ka theksuar se me kundërpropozuesin e parë janë marrë vesh që shuma e mbetur të paguhet menjëherë pasi që të vërtetohet kontrata e shitblerjes në Gjykatën Kompetente. Rrjedhimisht, propozuesi ka përgatitur dokumentacioni përkatës i cili i është bashkëngjitur këtij propozimi, respektivisht kontratën për shitblerje dhe fletëpagesën gjegjëse për shumën e mbetur. Ka shtuar se ndërkohë, propozuesi – blerësi ka dëgjuar se pas kësaj, shitësi ia ka shitur të njëjtën paluajtshmëri, blerësit tjetër, përkatësisht A. J. K. Mbi këtë bazë ka theksuar se paluajtshmëria mund të shitet edhe për të tretën herë, apo të ndërtohet mbi të ose edhe të bëhet ndonjë punë tjetër juridike e cila shkelë mbi të drejtën pronësore të propozuesit – blerësit të parë. Ka theksuar po ashtu se propozuesi ka interes juridik që tani pasi kontrata është lidhur midis tij e kundërpropozuesit dhe për këtë është paguar kapari, t'ia paguaj shitësit pjesën e mbetur të çmimit kontraktues e nëpërmjet kësaj të realizojë arondacionin për shkak të të cilit edhe ka blerë parcelën në fjalë, të përfundoj procedurën e kalimit të së drejtës dhe pastaj legalisht të realizojë objektivin e vetë. Më tej, ka theksuar po ashtu se është përfolur që nga persona për momentin të pa ditur, mund të tjetërsohet paluajtshmëria e sipërpërmendur, të ndërrohet gjendja ekzistuese ose në ndonjë mënyrë tjetër të ndikojë negativisht në të drejtën e propozuesit dhe me këtë t'ia bëjë të pamundur që të ketë në pronësi si pronar legjitim dhe në shfrytëzim të qetë këtë paluajtshmëri. Po ashtu më datë 27.09.2011 ka dorëzuar në Gjykatë një shtesë sqaruese, duke theksuar se kundërpropozuesi A. K, pronësia e të cilit është e kontestueshme, e ka ndërprerë me vetiniciativë ndërtimin e rrugës përgjatë kësaj parcele sipas projektit të kontraktuar nga Komuna e Prishtinës duke e ngushtuar gjerësinë e saj së paku një metër sipas matjeve gjeodezike të kryera nga personat e pa autorizuar nga Komuna dhe se ka indikacione se i njëjti do të fillojë me ndërmarrje të tjera në lidhje me këtë paluajtshmëri (shitje personit të tretë), çka do ta komplikoj edhe më tutje çështjen e pronësisë së truallit. Mbi bazën e të lartcekurave i ka propozuar Gjykatës caktimin e masës së sigurimit.

Në seancat dëgjimore, propozuesi i sigurimit ka mbetur pranë propozimit për caktimin e masës së sigurimit, duke theksuar se konform sugjerimeve të Apelit deklaroi se në këtë çështje deri më tani nuk ka paraqitur padi dhe se për këtë çështje nuk është duke u zhvilluar asnjë procedurë kontestimore, përveç këtij propozimi për caktimin e masës së sigurimit. Më tej, ka theksuar se që nga koha e paraqitjes së propozimit, më datë 12.09.2011 e deri më tani, i janë shkaktuar dëme enorme materiale. Po ashtu, i është referuar edhe përgjigjes së kundërshtarit të parë të sigurimit, duke kundërshtuar thëniet e tij se propozuesi është tërhequr nga transaksioni, pasi që i njëjti ka realizuar pagesa lidhur me pronën kontestuese, të cilat pagesa janë kërkuar

nga kundërshtari i parë i sigurimit, me qëllim të bartjes së pronësisë nga pronari paraprak tek ai. Mbi bazën e të lartcekurave ka kërkuar nga Gjykata që masa e sigurimit në këtë çështje të caktohet.

Kundërshtari i parë i propozimit, T. S, më datë 11.05.2012 ka paraqitur përgjigje në propozimin për caktimin e masës së sigurimit, përmes të cilës e ka kontestuar në tërësi propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurimit, me arsyetimin se nuk ka bazë ligjore për caktimin e një mase të tillë. Ka theksuar se është fakt se në vitin 2007 kanë rënë dakord me propozuesin për t'i shitur pronën për të cilën kërkohet masa e sigurimit. Më tej, ka theksuar se është po ashtu e vërtetë se nga propozuesi ka marrë shumën prej 1,450.00 € si paradhënie për patundshmërinë në fjalë, por nuk është e vërtetë se ka lidhur kontratë me shkrim me propozuesin për shitblerjen e kësaj paluajtshmërie, do të thotë një kontratë e tillë nuk ekziston. Ka theksuar se shitja e pronës sipas marrëveshjes gojore nuk është realizuar, pasi që vetë propozuesi ka hequr dorë dhe ka vendosur që të blejë prona të tjera pranë pronës në fjalë, në lidhje me të cilat prona ka qenë i angazhuar si ndërmjetës për gjetjen e pronarëve të atyre pronave, të cilët jetojnë në Serbi. Po ashtu, ka shtuar se arsye tjetër ka qenë edhe sipërfaqja e vogël dhe forma e truallit, sipas propozuesit, e pa përshtatshme. Ka theksuar po ashtu se pas blerjes së pronave të tjera, propozuesi kishte deklaruar se heqë dorë nga blerja e pronës në fjalë dhe me atë rast kishin rënë dakord që të pastronin paradhënien për shkak të shpenzimeve që kishte pasur për gjetjen e shitësve dhe shpërblimin për kryerjen e asaj pune. Në fund, ka theksuar se pasi që propozuesi ka refuzuar të blejë pronën në fjalë, të njëjtën ia kishte shitur blerësit tjetër d.m.th. A. K, nga P me të cilin ka lidhur kontratë të shitblerjes, të vërtetuar në gjykatë pasi i njëjti ka përmbushur detyrimet e tij. Mbi bazën e të lartcekurave, ka theksuar se propozimi mbi caktimin e masës së sigurimit, është i pa bazuar.

Kundërshtarit të parë të sigurimit, ftesat për seancat e caktuara dëgjimori, i janë dorëzuar përmes afishimit në tabelën e shpalljeve të kësaj Gjykate, konform vendimit C.nr.1992/2011, të datës 12.12.2023, pasi që Gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për dorëzim sipas nenit 116 të LPK-së. Megjithatë, kundërshtari i parë i sigurimit në seancat e mbajtura dëgjimore nuk ka prezantuar, andaj edhe i njëjti nuk ka mundur të deklarohet.

Kundërshtari i dytë i sigurimit A. K, përmes të autorizuarit të tij, më datë 06.04.2012 ka paraqitur përgjigje në propozim për caktimin e masës së sigurimit, me të cilën e ka kontestuar në tërësi si të pabazuar propozimin e cekur, nga shkakut se të njëjtit i mungon baza faktike si dhe baza juridike ligjore. Ka theksuar se mungesa e bazës faktike konsiston në faktin se në rastin konkret nuk ka pasur asnjë provë me të cilën do të dëshmohej se propozuesi ka qenë apo është në ndonjë raport juridik me kërkesa për të drejta reale apo të drejta tjera me kundërshtarin e sigurimit. Përkundrazi faktet e provojnë se kjo paluajtshmëri është pronë ekskluzive e kundërshtarit të sigurimit A. K, të cilën të drejtë i njëjti e ka fituar përmes punës së vlefshme juridike-kontratës mbi shitblerjen e lidhur në formën e shkruar dhe të regjistruar në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri. Ka shtuar se këtë realitet propozuesi i sigurimit e di sepse në verën e vitit të kaluar kur ka filluar ndërtimi dhe kubizimi i rrugës në atë zonë nga Komuna e Prishtinës, kundërshtari i sigurimit A. K, me gjeodet ka bërë shënimin e pikave kufitare dhe propozuesi në bisedë me të njëjtin është njoftuar se kjo paluajtshmëri është blerë nga kundërshtari i sigurimit A. K. Nga kjo rezulton se propozuesi i sigurimit nuk e ka bërë të

besueshme bazueshmërinë e kërkesës. Më tej, ka theksuar se me propozimin e bërë që të kufizohet ushtrimi i të drejtës së pronës për kundërshtarin e sigurimit Arsim Kelmendi, propozuesi kërkon që të shkilet parimi i të drejtës së pronës i garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Mbi bazën e të lartcekurave rezulton se në këtë rast mungon edhe baza juridike për paraqitjen e propozimit të tillë pasi që me kërkesëpadi nuk mundë të kontestohet puna juridike e cila nuk është në kundërshtim me normat imperative. Andaj, Gjykatës i ka propozuar që propozimin e propozuesit ta refuzoj si të pabazuar.

Në seancë dëgjimore, përfaqësuesi i kundërshtarit të dytë të sigurimit ka mbetur pranë përgjigjes në propozim duke e kontestuar në tërësi të pa bazuar propozimin për caktimin e masës së sigurimit. Ka shtuar se lidhur me plotësimin e kushtit të parë ligjor për caktimin e masës së sigurimit, kundërshtari i dytë i sigurimit vazhdon të theksojë se me propozuesin nuk ka pasur kurrfarë marrëdhënie juridiko civile dhe si rezultat i njëjti nuk ka mundur të rrezikoj apo të vështirësojë asgjë në realizimin e kërkesave të propozuesit në raport me kundërshtarin e parë të sigurimit. Duke u bazuar në deklaratimet e me sipërme i ka propozuar Gjykatës që propozimin për caktimin e masës së sigurisë ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata, pasi shqyrtoi me kujdes propozimin për masën e sigurisë, përgjigjet e kundërshtarëve të sigurimit, provat që gjinden në shkresat e lëndës si dhe deklaratimet e palëve ndërgjyqëse, erdhi në përfundim se propozimi i propozuesit të sigurimit për caktimin e masës së sigurimit në rrethanat aktuale, është i pa bazuar.

Me dispozitën e nenit 297 par. 1, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, përcaktohet: *“Masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij, dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.* Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, Gjykata vlerëson se kushtet për caktimin e masës së sigurimit janë bërja e besueshme e të drejtës subjektive dhe argumentimi i ekzistimit të rrezikut real, se pa caktimin e masës së sigurimit, propozuesit do t’i vështirësohej realizimi i të drejtës së tij subjektive. Sipas kësaj dispozite, këto kushte duhet të plotësohen në mënyrë kumulative.

Me nenin 300, par. 1 të LPK-së janë paraparë llojet e masave të sigurimit që mund të caktohen për sigurimin e kërkesave drejtuar ndaj sendit të caktuar apo një pjese të tij dhe atë: *“a) ndalimi kundërshtarit të sigurimit që ta tjetërsojë, fshehë, ngarkojë apo disponojë me pasurinë kah e cila është drejtuar kërkesa. Ky ndalim do të evidentohet në regjistrin publik përkatës; b) ruajtja e pasurisë të cilës i përket ndalimi nga pika a) e këtij paragrafi dhe atë duke u depozituar në gjykatë, nëse kjo është e mundshme, apo duke iu dorëzuar në posedim propozuesit të sigurimit apo personit të tretë; c) ndalimi kundërshtarit të sigurimit që të kryejë veprime me të cilat mund të dëmtohet pjesa e pasurisë kah e cila është drejtuar kërkesa, apo urdhri kundërshtarit të sigurimit që t’i kryejë veprimet e caktuara të nevojshme për tu ruajtur pasuria apo për tu ruajtur gjendja ekzistuese e rrethanave; d) autorizimi i propozuesit të*

sigurimit që t'i kryejë aktivitetet e caktuara. 300.2 Dispozitat e paragrafit 2 dhe 3 të nenit 299 të këtij ligji zbatohen edhe në rastin e sigurimit të kërkesës së drejtuar kah sendi i caktuar apo kah një pjesë e tij. 300.3 Masat e sigurimit nga ky nen nuk guxojnë në tërësi ta përfshijnë kërkesën që sigurohet me anë të tyre.”

Ndërsa me nenin 304, par. 3 të LPK-së është paraparë se *në propozim duhet të tregohen edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia, si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim.*

Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe propozimit të propozuesit, erdhi në përfundim se propozimi i tij për caktimin e masës së sigurimit është i pa bazuar për shkak se, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet nga neni 297 i LPK-së.

Gjykata, pretendimet e propozuesit i ka shqyrtuar në raport me masën të cilën propozuesi ka propozuar që të caktohet, andaj sa i përket kushtit të parë, që është besueshmëria e të drejtës subjektive të propozuesit, Gjykata vlerëson se propozuesi nuk e ka bërë të besueshme ekzistimin e të drejtës së tij subjektive. Fillimisht, konform sugjerimeve të Gjykatës së shkallës së dytë, gjykata ka gjetur se propozuesi nuk ka inicuar ndonjë padi lidhur me çështjen konkrete, megjithatë nga përmbajta e propozimit për caktimin e masës së sigurimit, shihet se propozuesi pretendon të drejtën e pronësisë në paluajtshmërinë objekt i këtij propozimi. Po ashtu, në po këtë propozim, propozuesi kishte theksuar se ka interes që pasi kontrata është lidhur midis tij e kundërpropozuesit të parë, dhe se për këtë është paguar kapari, t'ia paguajë shitësit edhe pjesën e mbetur të çmimit kontraktues, të përfundojë procedurën e kalimit të së drejtës dhe pastaj legalisht të realizojë objektivin e vetë. Nga deklaratimet e propozuesit të masës, shihet se i njëjti, besueshmërinë e të drejtës së tij subjektive e mbështetë në faktin e pagimit të shumës së caktuar në emër të kaparit për sigurimin e paluajtshmërisë në fjalë, ndonëse nga i njëjti është pohuar se çmimi i plotë i shitblerjes nuk është paguar. Gjykata pati parasysh faktin se në rastin konkret, objekt shqyrtimi kemi vetëm vlerësimin e plotësimin të kushteve ligjore për caktimin e masës së sigurimit, rrjedhimisht propozuesi në këtë fazë të procedurës duhet ta bëjë të drejtën e tij subjektive të besueshme e jo të bazuar. Megjithatë, në praninë e rrethanave të tilla, Gjykata gjeti se pagesa e çmimit prej 1,450.00 euro në emër të kaparit, sipas vërtetimit të datës 28.02.2007, si dhe pohimit të vetë kundërshtarit të sigurimit në përgjigjen e datës 11.05.2012, nuk është provë e mjaftueshme për ta bërë të besueshme ekzistimin e të drejtës subjektive të propozuesit (respektivisht të drejtën e pretenduar të pronësisë në paluajtshmërinë kontestuese).

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, propozuesi po ashtu nuk e ka bërë të besueshëm kushtin e dytë, se pa caktimin e masës së sigurimit, propozuesit do t'i vështirësohej realizimi i të drejtës së tij subjektive. Kjo, për faktin se nga deklaratimet e propozuesit në propozim dhe në seancë dëgjimore, si dhe nisur edhe nga natyra e këtij kontesti, propozuesi nuk ka arritur të argumentoj se ekziston rreziku real se kundërshtarët e sigurimit me veprimet e tyre do të mund t'ia pamundësonin apo vështirësonin dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë kontestuese, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën

do ta ndryshonin gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonin negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

Propozuesi, në propozim për caktimin e masës së sigurimit, ndër të tjera ka propozuar që kundërshtarëve të sigurimit t'u ndalohej që të ndërmarrin ndonjë veprim me qëllim të ndryshimit të gjendjes faktike ekzistuese, shitjes, bartjes në persona të tretë, ngarkimi me ndonjë të drejtë sendore ose detyrimore, në paluajtshmërinë – ngastrën kadastrale 05090-0 ZK Prishtinë, vendi i quajtur R. K. Gjykata, me propozimin e propozuesit ka siguruar historiatin kadastral të kësaj ngastre kadastrale. Nga shënimet e siguruar nga Drejtoria e Kadastrit pranë Komunës së P, Gjykata ka gjetur se prona kontestuese, ka figuruar fillimisht në emër të J. S, ndërsa sipas Aktvendimit të po kësaj Drejtorie, nr.011-952-1-1-1584 të datës 20.08.2010, e njëjta ka kaluar në emër të T. S, këtu kundërshtari i parë i sigurimit, mbi bazën e Aktvendimit të Trashëgimisë vërtetuar nga Gjykata Komonale në Prishtinë T.nr.205/10, të datës 21.07.2010. Ndërkaq, sipas Aktvendimit të po kësaj Drejtorie, nr.011-952-1-2023, të datës 20.10.2010, paluajtshmëria kontestuese ka kaluar në emër të këtu kundërshtarit të dytë të sigurimit A. K, duke u bazuar në Kontratën e shitblerjes Vr.nr.7783/2010, të datës 20.10.2010. Sipas certifikatës së pronës (draft certifikatës) të lëshuar më datë 03.10.2024, Gjykata gjeti se kjo paluajtshmëri vazhdon të figurojë në emër të kundërshtarit të dytë të sigurimit A.K.

Nisur nga një fakt i tillë, Gjykata gjeti se, fillimisht në raport me kundërshtarin e parë të sigurimit, T. S, nuk ekziston rreziku që i njëjti parcelën kontestuese, të identifikuar sipas numrit 05090-0 ZK P, mund ta shesë, ngarkojë apo tjetërsojë tek personat e tretë, kjo për faktin se shitja, ngarkimi dhe tjetërsimi i paluajtshmërisë është autorizim ekskluziv i pronarit të paluajtshmërisë. Ndërkaq, duke qenë se i njëjti nuk është i evidentuar si pronar i paluajtshmërisë kontestuese në regjistrat kadastral, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, kundërshtari i parë i sigurimit nuk mund të bëjë shitjen apo ngarkimin e kësaj paluajtshmërie.

Ndërkaq, për sa i përket kundërshtarit të dytë të sigurimit, A. K, në posedimin individual të të cilit evidentohet paluajtshmëria kontestuese, Gjykata vlerëson se propozuesi po ashtu nuk e ka bërë të besueshëm me asnjë provë rrezikun që paluajtshmëria kontestuese mund të tjetërsohet, duke ia vështirësuar ose bërë të pamundshme kështu realizimin e kërkesës së tij. Gjykata vë theksin mbi faktin se evidentimi i kundërshtarit të dytë të sigurimit si pronar (posedues individual) i pronës në fjalë, nuk nënkupton domosdo ekzistimin e rrezikut se prona do të tjetërsohet apo do të ndryshohet gjendja ekzistuese. Autorizimi i disponimit me sendin në pronësi, është autorizim i cili del nga vetë e drejta e pronësisë mbi atë send. Megjithatë, Gjykata vlerëson se vendosja e masës së sigurisë, bazuar vetëm mbi faktin se pronari i sendit ka autorizimin e disponimit me atë send, paraqet një kufizim të së drejtës së pronësisë, mbrojtja e të cilës garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës por edhe me Instrumentet Ndërkombëtare që gjejnë zbatim të drejtpërdrejtë në legjislacionin vendor.

Për t'u vlerësuar se plotësohet kushti nga neni 297 paragrafi 1 pika b) e LPK-së, propozuesi duhet të bëjë të besueshëm ekzistimin e rrezikut për ndryshimin e gjendjes ekzistuese, si rezultat i veprimeve të pronarit të pronës, e të cilat veprime ia vështirësojnë apo pamundësojnë realizimin e të drejtës subjektive propozuesit. Rreziku duhet të ekzistojë në momentin e propozimit, të jetë real e jo vetëm të supozohet se ekziston. Për më tepër, duhet të provohet

edhe rrethana se deri tek ky rrezik ka ardhur si rezultat i veprimeve aktive të kundërshtarit të masës, e jo si rezultat i ushtrimit të të drejtave të tij si pronar aktual i pronës. Në rastin konkret, propozuesi nuk e ka bërë të besueshëm ekzistimin e rrezikut se pa një masë të tillë pronari mund ta ndryshoj gjendjen ekzistuese me veprime të caktuara, qoftë me anë të tjetërsimit apo formave tjera, ngase me asnjë provë nuk është argumentuar ekzistimi i një rreziku të tillë, dhe vetëm deklarimi i propozuesit se një rrezik i tillë ekziston, nuk mund të përbëjë shkak për caktimin e masës së sigurimit.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, është përgjegjësi e propozuesit që me rastin e propozimit të masës së sigurimit, të paraqesë edhe provat relevante përmes të cilave do të argumentonte para Gjykatës, kushtet për caktimin e kësaj mase, të parapara në nenin 297, par. 1 të LPK-së.

Bazuar në të lartcekurat, Gjykata e refuzoi propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurimit, pasi vlerësoi se tani për tani, nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet ligjore të parapara me nenin 297.1 pika a) dhe b), e në lidhje me nenin 304 të LPK-së, për tu caktuar një masë e tillë.

Në këtë Aktvendim, objekt shqyrtimi është vetëm vlerësimi i pretendimeve në lidhshmëri me plotësimin e kushteve për caktimin e masës së sigurimit në kuptim të nenit 297 par.1 të LPK-së, dhe një vlerësim i tillë nuk e paraqyt kon edhe vendosjen e çështjes kryesore në rast se propozuesi inicon procedurë të rregullt kontestimore, sipas padisë, e cila do të vendoset me rastin e procedimit të rregullt, pas ndërmarrjes së veprimeve të parapara procedurale, dëgjimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe administrimit të provave të propozuara.

Nga sa u tha më lart, e konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 387.1 pika (l), lidhur me nenin 142.5 të LPK-së, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.3027/2024, më datë 26.12.2024

Gjyqtarja
Greta Ibraj

KËSHILLË JURIDIKE: Ndaj këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese brenda afatit prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.